



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr 12351 prot.

Shkodër, me 06.09.2023

Lënda: Dërgohet për shqyrtim projekt-vendimi dhe relacioni

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar këshilltarë,

Bashkëngjitur Ju dërgojmë për shqyrtim relacionin dhe projekt-vendimin **“PËR NJË SHITESË DHE NDRYSHIM NË BUXHETIN E BASHKISË SHKODËR TË MIRATUAR ME VKB NR. 71, DATË 27.12.2022 “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË SHKODËR PËR VITIN 2023 DHE PROGRAMIN AFATMESËM PËRFUNDIMTAR 2023-2025”, I NDRYSHUAR.**

Duke ju uruar punë të mbarë.

Me respekt,





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Nr _____ prot.

Shkodër, me _____.____.2023

PROJEKT-VENDIMI

Nr._____, datë____.____.2023

“PËR NJË SHITESË DHE NDRYSHIM NË BUXHETIN E BASHKISË SË SHKODRËS TË MIRATUAR ME VKB NR. 71, DATË 27.12.2022 “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË SHKODËR PËR VITIN 2023 DHE PROGRAMIN AFATMESËM PËRFUNDIMTAR 2023-2025”, I NDRYSHUAR.

Këshilli i Bashkisë Shkodër, sot me datë ___/___/2023, në mbështetje të nenit 28, pika 2, neni 54 germa ‘dh’ të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 ”Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar;ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar;ligjit nr.84,datë 24.11.2022”Për buxhetin e vitit 2023” të ndryshuar; VKM nr.125,datë 01.03.2023 “Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës financimit nga fondi i programit për bujqësinë e zhvillimin rural, për vitin 2023”; Udhëzim nr 5, datë 03.03.2023 ‘Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe Zhvillimin Rural”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”;të ndryshuar; Udhëzimit plotësues nr. 2, datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, i ndryshuar; VKB nr. 71, datë 27.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Shkodër për vitin 2023 dhe programin afatmesëm përfundimtar 2023-2025” të ndryshuar”; VKB nr. 15 datë 20.7.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare “Bio Strajca” sh.a. si person juridik në pronësi të Bashkisë Shkodër, miratimin e Aktit të Themelimit dhe Statutit; “Aplikimi nr.5110 prot. datë 11.04.2023 pranë AZHBR për masën 8 “Mbeshtetje për ndërtimin e tregjeve të produkteve bujqësore,tregjeve të kafsheve të gjalla ose thertoreve për shoqëritë tregtare me kapital 100% shtetror, të zotëruar nga njësitë e vetqeverisjes vendore, për Rikualifikim të merkatos Rus (Mbulesa e Tregut)”; shkresa nr. 11186 Prot. dt. 09.08.2023, “Njoftim me shkrim për miratimin e aplikimit” si dhe Urdhër Shpenzim nr.537, datë 30.08.2023 , akordim fondi nga Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, sipas materialit të përgatitur nga administrata e Bashkisë me propozim të Kryetarit të Bashkisë Shkodër,

V E N D O S I:

1. Miratimin e shtesës së planit të buxhetit të Bashkisë Shkodër për projektin “Rikualifikim i merkatos Rus (Mbulesa e Tregut)”. Projekti financohet nga AZHBR (Agjencia e Zhvillimit Bujqësor Rural) nën thirrjen Skema Kombëtare 2023 sipas Udhëzimit Nr. 5, datë 3.3.2023 “Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit përbujqësinë dhe zhvillimin rural”. Ky projekt do të përfshihet në programin P04130.Q2.O1.A5 “Rikualifikim i merkatos Rus (Mbulesa e Tregut)”, për zbatimin, supervizimin dhe kolaudimin e investimit në vlerën 36,622,584 lek me tvsh, në zërin investime, prej të cilave 29,155,811, sipas shkresës nr. 11186, datë 09.08.2023 si dhe Urdhër Shpenzim nr.537, datë 30.08.2023, akordim fondi nga Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural.

2. Miratimin e fondit shtesë prej 7,466,773 lek nga buxheti i miratuar me VKB nr. 71, datë 27.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Shkodër për vitin 2023 dhe programin afatmesëm përfundimtar 2023-2025” të ndryshuar” për realizimin e investimit të miratuar me projektin “Rikualifikim i merkatos Rus (Mbulesa e Tregut)” në programin P04130.Q2.O1.A5 “Rikualifikim të merkatos Rus (Mbulesa e Tregut)”, zbatim, supervizim dhe kolaudim.
Bashkëlidhur fish projekti përkatës.
Burimi i financimit do të jetë nga rialokimi i fondeve të mbetura gjendje nga viti 2022 përfshirë në buxhetin e vitit 2023 me VKB nr. 71, datë 27.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Shkodër për vitin 2023 dhe programin afatmesëm përfundimtar 2023-2025” të ndryshuar” si me poshtë:

TABELA 1
ne lekë

Pakësim Viti 2022

Fondet e Veta

Prog.	Emërtimi Programit	Llog. Ek.	Bashkia Qendër	Totali Pakësimit
4130	Mbështetja për Zhvillim Ekonomik	602	6,446,865	6,446,865
4130	Mbështetja për Zhvillim Ekonomik	604	238,395	238,395
5100	Menaxhimi i mbetjeve	602	100,000	100,000
6370	Furnizimi me ujë dhe Kanalizime	604	599,513	599,513

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al

	TOTALI SHPENZIME DHE TRANSFERIME		7,384,773	7,384,773
4130	Mbështetja për Zhvillim Ekonomik	231	82,000	82,000
	TOTALI SHPENZIME KAPITALE TË TRUPËZUARA		82,000	82,000
TOTALI			7,466,773	7,466,773

TABELA2

Shtesa viti 2023

Fondet e veta


ne lekë

Institucioni	Emërtimi i Aktivitetit	Shpenzime Kapitale të trupëzuara(231)	Totali 2023
Bashkia Shkodër	P04130.Q2.O1.A5. Rikualifikim i merkatos Rus (Mbulesa e Tregut), Zbatim	6,880,773	6,880,773
	Supervizim i zbatimit të projektit	542,000	542,000
	Kolaudim i projektit	44,000	44,000
	TOTALI	7,466,773	7,466,773


3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.



Zv. Kryetar




Drejtorja e Analizës dhe
e Programimit Buxhetor




Drejtorja e Juridike



Drejtorja Planifikimit Strategjik dhe
Permiresimit te klimes se Bisnesit



Drejtorja e Financës





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT STRATEGJIK DHE PËRMIRËSIMIT TË KLIMËS SË
BIZNESIT

Nr _____ prot.

Shkodër, me _____, 2023

RELACION

“PËR NJË SHITESË DHE NDRYSHIM NË BUXHETIN E BASHKISË SË SHKODRËS TË MIRATUAR ME VKB NR. 71, DATË 27.12.2022 “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË SHKODËR PËR VITIN 2023 DHE PROGRAMIN AFATMESËM PËRFUNDIMTAR 2023-2025”, I NDRYSHUAR.

Të nderuar këshilltarë,

Bashkia Shkodër me Projektin: “Rikualifikim i Merkatës Rus (Mbulesa e Tregut Shkodër)”, është përzgjedhur për financim në kuadër të thirrjes për propozime të shpallur nga Agjencia e Zhvillimit Bujqësor Rural (AZHBR), sipas shkresës nr. 11186 prot. datë 09.08.2023.

Ky projekt parashikon *Rikualifikimin e Merkatës Rus (Mbulesa e Tregut Shkodër)* duke ridimensionuar zonën për ta kthyer atë në një mjedis të përshtatshëm, i cili do të ofrojë hapësira të nevojshme për tregtim. Realizimi i mbulesës së tregut së bashku me 128 banakët e rinj për tregtarët do të përmirësojë kushtet e tregtimit duke e bërë me atraktive frekuentimin e këtij tregu nga të gjithë banorët por edhe vizitorët e shumtë si një atraksion i produktit lokal.

Tregu i Rusit (Merkata Rus) aktualisht funksionon me mbikqyrjen e bashkisë dhe dhënien e shërbimit të menaxhimit, pastrimit dhe ruajtjes. Tregu i Rusit ka pasur amortizimin e tij dhe mungesa e mbulesës së këtij tregu e bën të vështirë tregtimin në periudhën e shirave dhe verës nga dielli. Në Shkodër funksionon një treg lokal i formalizuar për produktet bujqësore por nuk është sipas kushteve bashkëkohore. Mungesa e një mbulesë të tregut ka bërë që të ulet numri i tregtarëve në këtë treg duke bërë që të kemi probleme sa i përket zënies së hapsirave publike. Për këtë arsye propozohet kjo ndërhyrje infrastrukturore në këtë treg për të bërë të mundur akomodimin e 128 tregtarëve të cilët paguajnë koston e shfrytëzimit të hapsirës publike për

tezgen/modulin që kanë në përdorim si dhe detyrimet e taksave dhe të tarifave për Bashkinë Shkodër.

Bashkia Shkodër me vendimin nr. 15 datë 20.7.2023 ka krijuar Sh.A. Bio Strajca me funksion administrimin e tregjeve të Bashkisë Shkodër në zbatim të VKM nr.125, datë 01.03.2023 “ Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës financimit nga fondi i programit për bujqësinë e zhvillimin rural, për vitin 2023”. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë aksionare është:

- a) Ofrimi i shërbimeve në fushën e zhvillimit ekonomik për mirëfunksionimin e tregjeve publike dhe rrjetit të tregtisë.
- b) Organizimin e shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor dhe ofrimin e shërbimeve cilësore ndaj komunitetit.
- c) Menaxhimi i tregjeve të produkteve bujqësore, tregjeve të kafshëve të gjalla, thertoret etj.

Me realizimin e investimit administrimi i këtij tregu do t'i kalojë Sh.a. Bio Strajca duke gjeneruar të ardhura për mirëmbajtjen e tij në vitet në vijim dhe mundësinë e krijimit të hapsirave të tjera tregtare në qytet.

Ndërhyrja e propozuar me projektin *Rikualifikim i Merkatës Rus (Mbulesa e Tregut Shkodër)* do të ridimensionojë zonën për ta kthyer atë në një mjedis të përshtatshëm, i cili do të ofrojë hapësira të nevojshme për tregtim. Realizimi i mbulesës së tregut së bashku me banakët e rinj për tregtarët do të përmirësojë kushtet e tregtimit duke e bërë me atraktive frekuentimin e këtij tregu nga të gjithë banorët por edhe vizitorët e shumtë si një atraksion i produktit lokal. Mbulesa do të ndihmojë tregtarët duke ju krijuar kushte të favorshme dhe mbrojtur produktet dhe tregtarët e klientët nga rreshjet dhe nga dielli i verës. Përmes këtij projekti propozohet përmirësimi i kushteve të tregtimit në merkaton Rus, duke ndërtuar 128 banakë të rinj dhe një mbulesë që krijon kushtet e përshtatshme për mbarëvajtjen e funksionimit të tregut pa u ndikuar nga kushtet atmosferike. Për këtë arsye propozohet krijimi i një mbulesë me strukturë metalike e cila do të shtrihet sipas një planimetrie të rregullt prej 1500 m². Gjithashtu do të ndërtohen 128 banakë të rinj duke rritur kështu edhe kapacitetin e këtij tregu.

Investimi i propozuar për realizimin e mbulesës dhe banakëve/moduleve të tregtimit të produkteve bujqësore në merkatën e rusit sipas preventivave parashikohet të jetë në vlerë totale **36,622,584** lek me tvsh. AZHBR do të financojë për Bashkinë Shkodër Vlerën prej 29,155,811 Lekë. Bashkia Shkodër do të mbulojë fondin prej **7,466,773** (shtatë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e tre).

Sa më sipër referuar bazes ligjore: nenit 28, pika 2, neni 54 germa ‘dh’ të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 ”Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar; ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të

ndryshuar;ligjit nr.84,datë 24.11.2022”Për buxhetin e vitit 2023” të ndryshuar; VKM nr.125,datë 01.03.2023 “Për përcaktimin e kritereve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës financimit nga fondi i programit për bujqësinë e zhvillimin rural, për vitin 2023”; Udhëzim nr 5, datë 03.03.2023 ‘Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe Zhvillimin Rural”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”; të ndryshuar; Udhëzimit plotësues nr. 2, datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”; VKB nr. 71, datë 27.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Shkodër për vitin 2023 dhe programin afatmesëm përfundimtar 2023-2025” të ndryshuar”; VKB nr. 15 datë 20.7.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare “Bio Strajca” sh.a. si person juridik në pronësi të Bashkisë Shkodër, miratimin e Aktit të Themelimit dhe Statutit; “Aplikimi nr.5110 prot. datë 11.04.2023 pranë AZHBR per masën 8 “Mbeshtetje për ndërtimin e tregjeve të produkteve bujqësore,tregjeve te kafsheve të gjalla ose thertoreve për shoqëritë tregtare me kapital 100% shtetror, të zotëruar nga njësitë e vetqeverisjes vendore, për Rikualifikim te merkatos Rus (Mbulesa e Tregut)”; shkresa nr. 11186 Prot. dt. 09.08.2023, “Njoftim me shkrim për miratimin e aplikimit” si dhe Urdhër Shpenzim nr.537, datë 30.08.2023 , akordim fondi nga Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, **kërkojmë nga ana juaj mundësinë e miratimit të këtij projekt vendimi për:**

1. Miratimin e shtesës së planit të buxhetit të Bashkisë Shkodër për projektin “Rikualifikim i merkatos Rus (Mbulesa e Tregut)”. Projekti financohet nga AZHBR (Agjencia e Zhvillimit Bujqësor Rural) nën thirrjen Skema Kombëtare 2023 sipas Udhëzimit Nr. 5, datë 3.3.2023 “Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”. Ky projekt do të përfshihet në programin P04130.Q2.O1.A5 “Rikualifikim i merkatos Rus (Mbulesa e Tregut)”, për zbatimin, supervizimin dhe kolaudimin e investimit në vlerën 36,622,584 lek me tvsh, në zërin investime, prej të cilave 29,155,811 grant i AZHBR sipas shkresës nr. 11186, datë 09.08.2023 si dhe Urdhër Shpenzim nr.537, datë 30.08.2023,akordim fondi nga Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural.
2. Miratimin e fondit shtesë prej **7,466,773** lek nga buxheti i miratuar me VKB nr. 71, datë 27.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Shkodër për vitin 2023 dhe programin afatmesëm përfundimtar 2023-2025” të ndryshuar” për realizimin e investimit të miratuar me projektin “Rikualifikim i merkatos Rus (Mbulesa e Tregut)” në programin P04130.Q2.O1.A5 “Rikualifikim të merkatos Rus (Mbulesa e Tregut)”, zbatim, supervizim dhe kolaudim.

Bashkëlidhur fish projekti përkatës.

Burimi i financimit do të jetë nga rialokimi i fondeve të mbetura gjendje nga viti 2022 përfshirë në buxhetin e vitit 2023 me VKB nr. 71, datë 27.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Shkodër për vitin 2023 dhe programin afatmesëm përfundimtar 2023-2025” të ndryshuar” si me poshte:

Prog.	Emërtimi Programit	Llog. Ek.	Bashkia Qendër	Totali Pakësimit
4130	Mbështetja për Zhvillim Ekonomik	602	6,446,865	6,446,865
4130	Mbështetja për Zhvillim Ekonomik	604	238,395	238,395
5100	Menaxhimi i mbetjeve	602	100,000	100,000
6370	Furnizimi me ujë dhe Kanalizime	604	599,513	599,513
	TOTALI SHPENZIME DHE TRANSFERIME		7,384,773	7,384,773
4130	Mbështetja për Zhvillim Ekonomik	231	82,000	82,000
	TOTALI SHPENZIME KAPITALE TË TRUPËZUARA		82,000	82,000
	TOTALI		7,466,773	7,466,773

TABELA 2
ne lekë

Shtesa viti 2023

Fondet e veta

Institucioni	Emërtimi i Aktivitetit	Shpenzime Kapitale të trupëzuara(231)	Totali 2023
Bashkia Shkodër	P04130.Q2.O1.A5. Rikualifikim i merkatos Rus (Mbulesa e Tregut), Zbatim	6,880,773	6,880,773
	Supervizim i zbatimit të projektit	542,000	542,000
	Kolaudim i projektit	44,000	44,000
	TOTALI	7,466,773	7466,773

Duke ju falenderuar!

KRYETAR



Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klime dhe Biznesit

Konceptoi: B. Memta

Nr.29	P04130.Q2.O1.A5 Rikualifikim i merkatos Rus (Mbulesa e Tregut) Zbatim, supervizim dhe kolaudim	Funksioni 4: Çështje ekonomike NN/Funksion 041: Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës Programi 04130: Mbështetja për zhvillim ekonomik
a) Përshkrim i shkurtër i projektit:		
i. Situata		
<p>Duke marrë parasysh numrin e lartë të prodhuesve të produkteve bujqësore e blegtorale dhe tregtarëve ambulant, Bashkia Shkodër ka realizuar një investim fillestar të infrastrukturës nën tokësore për rikualifikimin e Tregut Rus, duke krijuar mundësinë e akomodimit të 100 tregtarëve. Kjo ka ndihmuar në krijimin e mundësive të tregtimit në një hapsirë të dedikuar ku çdo i interesuar mund të tregtojë sipas marrëveshjes me bashkinë Shkodër për shfrytëzim të hapsirës publike në përdorim. Shkodra me 10 njësitë administrative ka një potencial të lartë të prodhimeve bujqësore dhe për bashkinë Shkodër krijimi i infrastrukturës së tregtimit të këtyre produkteve është me shumë rëndësi. Gjendja ekzistuese e objektit është e amortizuar me tezgja të vogla individuale të cilat krijojnë vështirsi në lëvizshmërinë dhe aksesin e konsumatorëve. Mbulesat e tezgave nuk ofrojnë një mbulim dhe mbrojtje të konsumatorëve e tregtarëve nga rreshjet dhe dielli duke krijuar probleme në tregtimin e produkteve. Mungesa e një mbulesë të tregut ka bërë që të ulet numri i tregtarëve në këtë treg duke bërë që të kemi probleme sa i përket zënies së hapsirave publike. Sipas aplikimit nr. 5110 prot. datë 11.4.2023 të Bashkisë Shkodër pranë AZHBR jemi shpallur fitues sipas shkresës nr. 11186 datë 09.08.2023 për projektin e “Rikualifikimit të merkatos Rus mbulesës së tregut”, si dhe urdhër Shpenzim nr.537, datë 30.08.2023 , akordim fondi nga Agjencia për Zhvillim bujqësor dhe Rural, në shumën prej 29,155,811 lekë (njëzet e nëntë million e njëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e njëmbëdhjetë) . Realizimi i këtij projekti për ndërtimin e mbulesës së bashku me banakët e rinj për tregtarët do të përmirësojë kushtet e tregtimit duke e bërë me atraktive frekuentimin e këtij tregu nga të gjithë banorët por edhe vizitorët e shumtë si një atraksion i produktit lokal. Mbulesa do të ndihmojë tregtarët duke ju krijuar kushte të favorshme dhe mbrojtur produktet nga dielli i verës si dhe duke ndikuar në aksesin në treg edhe gjatë ditëve me rreshje shiu. Përmes këtij projekti propozohet përmirësimi i kushteve të tregtimit në merkaton Rus, duke ndërtuar 128 banakë të rinj dhe një mbulesë që krijon kushte e përshtatshme për mbarëvajtien e funksionimit të tregut pa u ndikuar nga kushtet atmosferike. Për këtë arsye propozohet ndërtimi i një mbulesë me strukturë metalike e cila do të shtrihet sipas një planimetrie të rregullt prej 1500 m2. Sipas zgjidhjes së propozuar do të krijohën pasazhe kalimi të bollshme për qytetarët që do të frekuentojnë tregun, por jo vetëm, plani i ri i propozuar mundëson ri organizim të ekspozitorëve ku tregtarët do të reklamojnë produktet e tyre duke garantuar gjithashtu dhe hapësirën funksionale që i nevojitet secilit prej tyre për të tregtuar produktet në kushte sa më të mira.</p>		
ii. Synimi i projektit		
Përmirësimi i infrastrukturës së tregtimit në merkaton Rus duke siguruar kushte të përshtatshme të tregtimit nëpërmjet ndërtimit të mbulesës së tregut dhe banakëve të rinj.		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
<ol style="list-style-type: none"> 1. Procedura të akordimit të fondit nga AZHBR; 2. Procedurat e tenderimit të zbatimit të projektit; 3. Ndërtimi i mbulesës dhe banakëve të tregut të shitjes me pakicë 4. Mbikqyrje 5. Kolaudimi 		
b) Rezultatet që prisni		
<ol style="list-style-type: none"> 1) Ndërtim i mbulesës së tregut të produkteve bujqësore në Merkaton Rus 2) Ndërtimi i 128 banakëve të rinj 3) Përmirësimi i standardeve të tregtimit 4) Përmirësim i kushteve të konsumatorëve 		
c) Aktorët e mundshëm	d) Kontributet e mundshme në projekt	

BashkiaShkodër		AZHBR (Agjencia e Zhvillimit Bujqësor Rural)				
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet		Totali (mije lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Zbatimi i projektit Rikualifikim të merkatos Rus (Mbulesa e Tregut)	36,036.584				36,036.584
A.2	Supervizim i zbatimit të projektit	542				542
A.3	Kolaudim i projektit	44				44
	Shuma	36,622.584				
f) Periudha e zbatimit 2023		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtorja e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit Drejtorja e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve Institucioni likujdues: BashkiaShkodër				